



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rr "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1041/7 Prot.

Tiranë, më 20.12.2018

V E N D I M

Nr. 231, Datë 20/12/2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS KAPSHTICË, "MBI
PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE"
për periudhën nga data 01.10.2015 deri më datën 30.09.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Kapshticë, rezultoi që, ka mospërputhje në procedura, të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e institucionit në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të subjekteve të biznesit dhe individëve, objekt i veprimtarisë së doganave, të cilat kanë sjellë për pasojë mungesë të ardhurash për buxhetin e shtetit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit, "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare", të ushtruar në Degën e Doganës Kapshticë, sipas programit të auditimit nr. 1041/1prot., datë 17.09.2018, për veprimtarinë nga data 01.10.2015 deri më datën 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Dega Doganore Kapshticë nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse përcjellë me shkresën përcjellëse nga KLSH me shkresën nr. 794/10prot., datë 31.12.2015 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1114/59prot., datë 20.01.2017, për:

a. Zbatimin e rekomandimit për 2 masa organizative, të cilat nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultojnë në proces.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime në shumën 75,754,116 lekë, të cilat nuk janë zbatuar.

c. Nga rekomandimet për shpërblim dëmi të cilat janë në ndjekje në vijimësi nuk është arkëtuar shuma 11,893,147 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet nr. 15-20 të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë, në cilësinë e “autoritetit doganor kompetent” të analizojnë rekomandimet e pa realizuara, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës së dëmit ekonomik prej **75,754,116 lekë** rekomanduar më parë në Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse përcjellë me shkresën përcjellëse nga KLSH nr. 794/10, datë 31.12.2015.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, ashtu sikurse dhe degët e tjera doganore, kjo degë nuk përfshihet në hartimin e programimit të të ardhurave, por treguesit i vijnë të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Vlen të theksohet se për periudhën objekt auditimi nga DPD, plani i të ardhurave nuk i është përcjellë degës në kohë që dhe ajo të merrte masa për realizimin e të ardhurave, por janë sjellë pas mbylljes së muajit e deri me dy muaj vonesë, kështu: plani i të ardhurave të muajit janar 2018 është dërguar nga DPD më datë 05.03.2018 dhe ka mbërritur në DDKapshticë më datë 20.03.2018, ose ka muaj që plani u dërgohet në rrugë elektronike, gjithashtu me vonesë, sikurse ka ndodhur me periudhën shtator- dhjetor 2017. Kjo mënyrë e planifikimit por dhe e detajimit mujor të planit të të ardhurave nga ana e DPD tregon për një planifikim jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, kap. IV. “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 20-22 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë të bashkëpunojë në të ardhmen me Sektorin e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave në DPD në të gjitha fazat e programimit të të ardhurave, me qëllim shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave, por dhe ato problematike, për të bërë të mundur që treguesit e të ardhurave të dërgohen në kohë dhe të programohen drejt e pa rezerva, duke eliminuar praktikën e deritanishme, ku ato vijnë të gatshëm nga DPD

Menjëherë dhe në vijimësi

3. -Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vlerësimit doganor të mallrave të deklaruar në kapitullin *44* nga subjekte të veçantë për periudhën e aktivitetit të audituar ka diferenca të mëdha midis deklarimeve për njësinë e peshës indeksi M3/Kg me një luhatje nga vlera

sasiore 394/kg/m³ deri në vlerën sasiore 1200kg/m³ për artikullin “Dru zjarri” dhe një luhatje nga vlera sasiore 378/kg/m³ deri në vlerën sasiore 1650kg/m³ për artikullin “Trungje Pische”. Gjithashtu konstatohet se për rastet e deklarimit të mallrave lëndë drusore gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018 nuk janë kryer veprime të mëtjshme verifikuese gjatë procedurës deklaruese dhe kontrole pas zhdoganimit në ambientet e operatorit deklarues më qëllim përcaktimin e saktë të sasisë së shprehur në njësinë m³ dhe kodet tariforë *4401* dhe *4403* ku deklarohen “Lëndët Drusore” pasi janë të përshtirë si kode me profil të lartë risku nga Drejtoria e Analizës së Riskut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për verifikime dhe kontrole fizike me indekse të standardizuara në njësinë “m³” ose një njësinë “kg”. Për mallrat e deklaruar në kreun *0703* konstatohet nuk është kryer mostrim laboratorik me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të artikullit “hudhër” sipas përcaktimeve të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, megjithëse disa praktika doganore kanë qenë të kanalizuar në profil risku për kontroll të plotë fizik. Nga administrimi i kriterëve të riskut të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Analizës së Riskut, konstatohet se profili i riskut **RNDHIT_F dhe SKAN_4** të përfshira për kodin tarifor *0703* kërkojnë kontroll të plotë fizik dhe dokumentar dhe skanimin e mallit, por nuk kërkojnë procedurën e detyrueshme doganore të mostrimit të mallit për efekt keqklasifikimi doganor të këtij malli nga kreun *0703* me tarifë 2% në kreun *0703* me tarifë 10%. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 39-41 dhe 53-54 të Raportit të Auditimit).

3.1- Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të ndërtojë programe kontrolli verifikuese për praktikën doganore që rezultojnë të konstatuara në këtë Raport Auditimi në kodet tariforë *4401* dhe *4403* ku deklarohen *Lëndët Drusore* me qëllim verifikimin e saktësisë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratat doganore të deklaruara dhe që do të deklarohen kontrollin fizik dhe kontabël pranë selive të operatorëve deklarues me qëllim evidentimin e shmangieve të sasive të deklaruara në indeksin deklarues Sasi për/m³. Gjithashtu krerët tariforë *4401* dhe *4403* të përshtihen si kode me profil të lartë risku nga Drejtoria e Analizës së Riskut pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave për kontrole fizike të detyrueshme gjatë procedurave deklaruese në lidhje me indekse të standardizuara në njësinë “m³” ose një njësinë “kg” nisur edhe nga fakti që indeksi referues i vlerës doganore sipas Dosjes së të Dhënave të Disponueshme është e shprehur në njësinë matëse sasi/m³.

3.2- Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës së Riskut në DPD të rishqyrtojnë profilin e riskut **RNDHIT_F dhe SKAN_4** të përfshira për kodin tarifor 0703 me qëllim rivendosjen e procedurës së detyrueshme doganore të mostrimit të mallit për efekt keqklasifikimi doganor të këtij malli nga kreun *0703* me tarifë 2% në kreun *0703* me tarifë 10% duke e azhornuar këtë profil risku si një kriter të zbatueshëm për të gjitha deklaratimet kombëtare që janë kryer dhe do të kryhen pranë Administratës Doganore në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

4. - Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vlerësimit doganor të mallrave “Goma të reja” të deklaruar të importuara nga kompania [REDAKTUAR] me Nipt [REDAKTUAR] konstatohet se përfitimi i kushtit të deklarimeve sipas kushtit të Origjinës Preferenciale (MSABE), rezulton të jetë i deklaruar nga kompanitë eksportuese me seli aktiviteti në GREQI të cilat nuk rezultojnë të jenë me status prodhues të këtyre mallrave. Konstatohet se origjina e mallrave të lëvruara nga këto kompani me seli në GREQI është e ndryshme nga origjina e shtetit eksportues dhe lëvruet të këtyre mallrave dhe konkretisht me origjinë “ES, DE, TR, FR, GB, LU, PL, XS, RO etj”. Në dokumentet EUR.1 bashkangjitur këtyre deklarimeve në kutinë nr. 2 dhe nr. 4 përcaktohet fusha e deklarimit EU-

ALBANIA dhe EU-GREQI. Nga kompanitë levruese mungon prova e dokumentimit të përfitimit të kumulimit diagonal të trajtimit tarifor preferencial sipas Marrëveshjes MSABE me nr. Shtojcës IV të Ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”. Gjithashtu nuk rezultojnë të kryera dhe të kërkuara verifikime doganore nga Dega Doganore Kapshticë në lidhje me këto konstatime të grupit auditues pranë selive të kompanive eksportuese me seli aktiviteti në GREQI të cilat nuk rezultojnë të jenë me status prodhues të këtyre mallrave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-47 të Raportit të Auditimit).

4.1- Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të kryejë verifikimet e dëshmime të origjinës të Deklaratave EUR.1 të trajtuara në këtë Raport Auditimi si dhe të garantojë shumën e garancisë doganore në përputhje me detyrimet tarifore respektive për çdo deklaram të kryer për pjesën e detyrimeve doganore të munguara që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjes negative nga Autoritetet Doganore Homologe Greke dhe ato të Shteteve Anëtare të BE dhe të shteteve me të cilët Shqipëria ka Marrëveshje Tarifore Preferenciale bazuar në nenin 204 “Personi që jep garancinë”, nenit 205/ 206/ 207/ 208/ 209/ 210/ 211/ 212/ 213 dhe 214 të Kodit Doganor të shfuqizuar, nenit 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i ri doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 derinë përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Auditimi.

4.2- Rekomandimi: Dega Doganore Kapshticë nëpërmjet specialistit të Kontrollit Pas Zhdoganimit në DDKapshticë në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit, Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës dhe Drejtorinë e Kontrollit Pas Zhdoganimit në Departamentin Operativ Hetimor në DPD, në bazë të nenit 102 të Kodit Doganor sipas ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar për periudhën 01.10.2015 deri më 31.06.2017, dhe nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë” për periudhën 01.07.2017 dhe në vijim të ndërtojë programe kontrolli hetimore specifike verifikuese për praktikën doganore që janë përpunuar sipas konstatimeve të përcaktuara.

Menjëherë

5.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor për periudhën nën auditim, rezulton se gjendja e borxhit në fund të periudhës audituese (datë 30.09.2018) krahasuar me fillimin e periudhës audituese (datë 01.10.2015), është pakësuar me 57 raste, me 25 subjekte debitorë, ndërsa në vlerë është pakësuar me 30,651 mijë lekë ose 33.8 %. Nga Dega e Doganës Kapshticë nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 59,908 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 74-86 të Raportit të Auditimit).

5.1- Rekomandimi: DD Kapshticë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe institucione të tjera të përmendura në Udhëzimi nr. 4, datë 07.04.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, të marrin masa konkrete dhe efektive nëpërmjet një programi të posaçëm për të zgjidhur në rrugë ligjore problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën prej 59,908 mijë lekë, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin e Auditimit, nga Dega e Doganës Kapshticë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e të ardhurave të munguara **në Buxhetin e Shtetit në shumën 206,692,104 lekë** në mënyrë analitike sipas anekseve në faqe nr. 22-74 si më poshtë:

1.- Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikave doganore IM4 dhe procedurave të ndjekura lidhur me deklarinimin e mallrave, u konstatua:

- Trajtim me transaksion i mallrave të importuar, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I dhe II të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...*” në shkellje të nenit 35, pika 2, germa “a” dhe “b”, nenit 36, pika 1, ndryshuar me nenin 67, pika 1, germa “d/i”, nenin 70, pika 2, germa “a”; nenin 70, pika 3 të Kodit Doganor, për **885 raste, në vlerën 135,444.7 mijë lekë**,

- Trajtim me origjinë preferenciale të artikujve me deklarata faturë, vlera e të cilëve e kalon shumën **6,000 euro**, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e: nenit 1, germa “l” Titulli I, nenit 22 dhe nenit 26, Titulli V, të Udhërrëfyesit të MSABE “*Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë*”; Keqklasifikim i kodit tarifor të artikujve në kuadratin 31 dhe 33 të DAV me pasojë shmangien e detyrimeve doganore dhe të akcizës, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256, pika 4; 261, pika 1, pika 2, ndryshuar me nenet 250, pika 4, 251, pika 2, germa “a”; 256, pika 1, germa “a” dhe “b”, të Kodit Doganor, për **703 raste, në vlerën 59,351,530 lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 22-59 të Raportit të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: D.D.Kapshticë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore për **1588 raste, në vlerën 194,796,226 lekë**, referuar nenit: 28, pika 1 dhe 3, germa “a”; 35, pika 2, germa “a” dhe “b”; 36, pika 1; 256, pika 4; 261, pika 1, 2 dhe 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar me nenet: 67, pika 1, germa “d/i”; 70, pika 2, germa “a”; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, germa “a”; 256, pika 1, germa “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë*”. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në anekset nr: 3.1 deri 3.24 të Raportit të Auditimit).

Deri më datën 31.01.2019

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike u konstatuan veprime të afateve dhe sasive autorizuese që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike që janë autorizuar të operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv dhe regjimeve doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm, veprime këto, jo në përputhje me: kërkesat e nenit 83, 160, 256, 273, 271 të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “*Kodi Doganor në RSH*”, i ndryshuar; ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar; VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “*Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv*”, përkatësisht për **5 raste, në vlerën 3,916,684 lekë** për regjimin e përpunimit aktiv dhe për **19 raste, në vlerën 3,599,194 lekë** për regjimin e lejimit të përkohshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 dhe 4.2, faqe 59-72 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi. D.D.Kapshticë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore **për 24 raste, në vlerën 7,515,878 lekë**, (nga të cilat shuma prej 3,916,684 lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA dhe shuma prej 3,599,194 lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP). DD Kapshticë të ndjekë dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RLP dhe RPA konform përcaktimeve të nenit 83 dhe 160 të Kodit Doganor në RSH, me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallrat e hyra në territorin doganor shqiptar me deklarime doganore IMP5 sipas procedurave të zgjeruara doganore 5100 dhe 5500 të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në anekset nr. 4.1 dhe 4.2 të Raportit të Auditimit).

Deri më 31.01.2019

3.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore të operatorëve që kanë operuar nën mbikëqyrjen doganore në regjimin e tranzitit (T1), nga ana e transportuesit, rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 119.1/a pasi nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit. Nga doganieri i kontrollit dokumentar/fizik në pikën e kontrollit nuk është vepruar në përmbushje të detyrave funksionale në përputhje me kërkesat e nenit 285.3 ndryshuar me nenin 273.3 të KD, pasi nuk është mbajtur procesverbal konstatimi referuar nenit 256.2 dhe 260.b të KD, ndryshuar me nenin 257.1/b të KD, **për 105 raste, në vlerën 4,380,000 lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.3, faqe 72-74 të Raportit të Auditimit).

3.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërbimin e dëmit për **105 raste, në vlerën 4,380,000 lekë.** (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4.3 të Raportit të Auditimit).

Deri më datën 31.01.2019

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 59, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 11, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa “b” deri “c”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

1. Për **z. H. C.**, me në cilësinë ish përgjegjës turni, aktualisht me detyrë përgjegjës turni në Degën e Doganës Korçë;
2. Për **z. V. T.**, me në cilësinë ish përgjegjës turni, aktualisht me detyrë përgjegjës turni në Degën e Doganës Korçë;
3. Për **z. Sh. S.**, me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;

4. Për z. A. Sh., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
5. Për zj. O. V., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
6. Për z. A. V., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
7. Për z. R. M., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
8. Për z. E. N., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
9. Për zj. K. Xh., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
10. Për z. A. N., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
11. Për zj. L. B., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
12. Për z. I. M., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
13. Për z. E. D., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
14. Për z. F. S., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
15. Për zj. L. D., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
16. Për z. A. B., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në Sektorin e Vlerës në Qendër;
17. Për z. G. K., me detyrë doganier kontroll fizik/klasifikim/vlerë;
18. Për z. E. C., me detyrë doganier kontroll fizik/klasifikim/vlerë;
19. Për z. F. B., me detyrë doganier kontroll fizik/klasifikim/vlerë;
20. Për z. M. Z., me detyrë doganier kontroll fizik/klasifikim/vlerë;
21. Për z. S. L., me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontroll fizik/klasifikim/vlerë;
22. Për z. E. M., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa “b” deri “c”, përkatësisht:**

1. Për Z. O. Gj., me detyrë dhe në cilësinë e ish përgjegjës turni;
2. Për Z. K. P., me detyrë dhe në cilësinë e ish doganier i kontrollit fizik;
3. Për Z. A. Sh., me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim;

4. Për Z. G. L., me detyrë dhe në cilësinë e ish doganier i kontrollit fizik.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

F. TË TJERA.

Për vetë ngarkesën e punës në auditime të tjera, ky auditim mund të ishte më i plotë. Për këtë arsye, kjo periudhë do të riauditohet përsëri në auditimin e radhës në vitin 2019.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R